



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

382P.

URDHËR

Nr. 26, Datë 21 2017

PËR

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E  
CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK,  
MIRATUAR ME URDHËR NR.37, DATË 16.03.2016”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 1 të nenit 19, germës c) të nenit 23, germës c) të nenit 24 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe struktura përgjegjëse për shërbimet mbështetëse në Ministrinë e Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

Në Rregulloren për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhërin nr.37, datë 16.03.2016, bëhen këto shtesa dhe ndryshime, si mëposhtë:

**Në kapitullin e II-të:**

Në nenin 6, pika 5 hiqet.

Në nenin 7, pika 5 hiqet.

**Në kapitullin e III-të:**

Në nenin 9, pika 3 hiqet.

Në nenin 13, në pikën 1, te paragrafi i dytë hiqet togfjalëshi “dhe moduli specifik për kandidatë të veçantë”.

Në nenin 13, pikat 2,3 dhe 8 hiqen.

Në nenin 14, te paragrafi i parë hiqet fjala “moduli specifik”, si dhe pika 1.

Në nenin 15, te pika 4, fjala “5 ditë pune”, bëhet “1 ditë pune”.

Në nenin 15, pika 6 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Kandidatët të cilët kanë rezultuar si jo kalues në 2 teste paraprake të moduleve bazë dhe në njërin nga testet paraprake të moduleve të radhës të mbetura pa u nënshtruar testimi mungojnë për arsye objektive, si: (rast sëmundje, vdekjen e një të afërmi brenda familjes, apo ndodhjen jashtë shtetit për arsye pune ose shëndetësore), atëherë ata kanë të drejtë t’i nënshtrohen testimi paraprak për modulën që kanë munguar. Në çdo rast qëllimi i mungesës duhet të justifikohet me dokumenta përkatëse, të lëshuar nga institucionet e lejuara nga ligji”.

Në nenin 16, pika 3 hiqet.

Në nenin 18, në pikën 9 hiqet fjala “të modulit specifik”.

Në nenin 21, shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“Aplikantit të cilit u njihet certifikata profesionale ndërkombëtare e fituar jashtë vendit, pajiset nga Komisioni me vërtetim, si një dokument që është i barazvlefshëm me certifikatën “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”.